



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 5581 Prot

Tiranë, më 27.09 2018

UDHËZIM

Nr. 677, datë 27.09 2018

PËR


PËRCAKTIMIN E FORMAVE, AFATEVE DHE MËNYRAVE TË RAPORTIMIT
PERIODIK, PËR VEPRIMTARITË E USHTRUARA DHE KATEGORITË E
PERSONAVE TË PUNËSUAR NGA NDËRMARRJET SOCIALE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.65/2016, datë 09.06.2016, "Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Miratimin e Formatit të Raportimit Vjetor të Ndërmarrjeve Sociale në Republikën e Shqipërisë, për veprimtaritë e ushtruara dhe kategoritë e personave të punësuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
2. Periudha e raportimit të veprimtarisë së personave juridikë që gëzojnë statusin e ndërmarrjes sociale është viti kalendarik, i cili është në përputhje me vitin financiar të ushtrimit të veprimtarisë së saj.
3. Periudha e raportimit të veprimtarisë së personave juridikë që gëzojnë statusin dhe ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e ndërmarrjes sociale, është nga data e regjistrimit deri në datën 31 Dhjetor për vitin e parë të aktivitetit.
4. Raportimi sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij Udhëzimi, është në formë të shkruar dhe përmban një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së ndërmarrjes sociale.
5. Personave juridikë që gëzojnë statusin e ndërmarrjes sociale, në rast të mosplotësimit me të dhëna të plota të formatit bashkëlidhur këtij Udhëzimi, u kërkohet të plotësojnë informacionin e kërkuar brenda 10 ditëve nga momenti i marrjes së njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


MINISTRI
Ogerta Manastirliu

Adresa: Rruga e Kavajës, Nr. 1001, Tirana, Albania. Tel: +355 42376178/ext 72125. www.shendetesia.gov.al

FORMATI I RAPORTIMIT VJETOR

PJESA I

1. Fusha e veprimtarisë së organizatës dhe vizioni:

(Përshkrimi i fushës aktuale të veprimtarisë dhe vizionit të organizatës në tre vitet e ardhshme. Vizioni është një objektiv konkret dhe ideal, i cili nuk është aktualisht i realizueshëm, por megjithatë duhet synuar për të. Përshkrimi duhet të jetë i shkurtër dhe konciz.)

Fusha e veprimtarisë së organizatës dhe vizioni:	
Veprimtaria juaj ekonomike është në fushën e prodhimit të mallrave apo ofrimit të shërbimeve?	
Përshkruani cilat aspekte sociale janë në fokus të veprimtarisë suaj.	
Çfarë kontributi jep ndërmarrja sociale në zgjidhjen e këtyre problemeve sociale?	

2. Informacion i përgjithshëm mbi ndërmarrjen sociale:

Emri i ndërmarrjes sociale	
Vendndodhja/ zyra qendrore	
Kur është themeluar ndërmarrja sociale	
A ka degë të tjera?	
Detajet e Kontaktit (Adresa, telefoni, fax, e-mail dhe website)	
Ekipi aktual i menaxhimit	
Akreditime/Çertifikime	

3. Profili i punonjësve:

(Plotëso në tabelën më poshtë numrin e përgjithshëm të personave të cilët janë të angazhuar në ndërmarrjen sociale gjatë vitit në shqyrtim dhe vitit paraardhës duke i klasifikuar ato në punonjës me pagesë të rregullt, punonjës nga grupet e pafavorizuara, të angazhuar si vullnetarë dhe/ose si ekspertë të pavarur).

Numri i punonjësve	Viti raportues 201_	Viti i mëparshëm 201_
Numri total i të punësuarve		
Numri i të punësuarve nga grupet e pafavorizuara dhe kategoritë përkatëse		
Numri i të angazhuarve si vullnetarë		
Informacione të tjera me rëndësi për raportimin		

4. Qëllimi i raportimit

Qëllimi	<i>(Përshkruaj në një fjali se çfarë ka bërë organizata për arritjen e objektivave sociale dhe mbajtjen e një veprimtarie të vazhdueshme në fushën e ofrimit të shërbimit ose prodhimit të mallrave.) A ka ndryshuar qëllimi i ndërmarrjes sociale që nga viti i kaluar? Nëse po, cila është arsyeja)</i>
Periodha e raportimit	<i>(Periodha e raportimit është viti kalendarik i cili është në përputhje me vitin financiar. Nëse është një organizatë e re, periodha e parë e raportimit është nga data e regjistrimit deri në datën 31 Dhjetor për vitin e parë.)</i>
Person i kontaktit	<i>(Personi që duhet të kontaktohet nëse është e nevojshme të merren informacione shtesë.)</i>

PJESA II

1. Sfidat dhe problemet sociale dhe dhënia e zgjidhjeve

Sfida/Problematika	Grupi i synuar	Puna e kryer (outputet)	Rezultatet e pritura

2. Përdorimi i burimeve

Burimet financiare	<i>Shpenzimet operative dhe të personelit, përfshirë shpenzimet administrative</i>
Burimet materiale	<i>Prona/objektet e përdorura (për shembull,</i>

	<i>automjetet ose materiale mësimore, sallat dhe objektet.</i>
Burimet jo materiale	<i>Njohuritë dhe aftësitë e punonjësve Njohuritë/ kultura/ patentat/ licencat/ të drejtat e autorit të organizatës. Bashkëpunimet dhe marrëdhëniet me partnerët, publikun, grupet e synuara, etj</i>
Burimet në kohë	<i>Orët që ka kontribuar stafi vullnetar dhe angazhimi i partnerëve vullnetarisht.</i>

PJESA III

Raportimi financiar

Përcaktoni mënyrën e financimit të projektit (Për të zgjedhur shënoni me X)	Financim vetëm nga format e mbështetjes së Ndërmarrjes Sociale	Financim nga donatorë të tjerë dhe format e mbështetjes së Ndërmarrjes Sociale	Financim nga institucione të tjera dhe format e mbështetjes së Ndërmarrjes Sociale

Përcaktoni % e financimit të projektit (Shënoni financimin e marrë në %)	Financim vetëm nga format e mbështetjes së Ndërmarrjes Sociale	Financim nga donatorë të tjerë dhe format e mbështetjes së Ndërmarrjes Sociale	Financim nga institucione të tjera dhe format e mbështetjes së Ndërmarrjes Sociale

Pagesat	Data e lëvrimit	Data e raportimit
Pagesa e parë		
Pagesa e dytë		